



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA PRIVATE E ARSIMIT TË LARTË "PAVARËSIA", VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prof. 132

Vlorë më, 03 / 11 / 2016

V E N D I M N r. 22

i Senatit Akademik të SHPALPV

“Mbi regjistrimin e kandidateve për studentë në SHPALPV, që nuk kanë aplikuar në Portalin e Maturës Shtetërore 2016 -2017, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 13, datë 22.07.2016”

Senati Akademik i SHPALPV, i mbledhur sot, datë 02.11.2016,

- Mbështetur në nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”;
- Bazuar në rezultatet e regjistrimeve sipas sistemit të ri të aplikimeve për arsimin e lartë;
- Bazuar në korrektësinë tonë maksimale institucionale në funksion të një procesi transparent dhe efektiv;
- Duke marrë në shqyrtim kërkesat e kandidateve për studentë të SHPALPV, që nuk e kanë fituar ende statusin e studentit të këtij institucioni;
- Duke marrë në konsideratë:
 1. Mos regjistrimin gjatë dy rraundeve të para, të kandidateve për studentë që nuk kanë aplikuar në maturën shtetërore për arsye mos informimi, mos kuptimi të procesit, paqartësive dhe vonesave njerëzore;
 2. Mos regjistrimin në programin e dëshiruar, të studentëve që kanë aplikuar ndërkaq në maturën shtetërore;

3. Mos regjistrimin në institucionin tonë të studentëve të sipërthënë edhe pse ata janë brenda të gjitha kritereve shtetërore të arritjes së mesatares së kërkuar dhe kritereve institucionale të renditjes sipas kuotave dhe vijës së kuqe.

VENDOSI:

1. Të pranojë aplikimet dhe regjistrimet në SHPALPV të grupit të kandidatëve për studentë, që nuk kanë mundur të aplikojnë sipas afateve të parashikuara në dy raundet e para të maturës shtetërore, sipas preferencave të tyre, në programet që ofrohen në SHPALPV!
2. Të pranojë aplikimet dhe regjistrimet në SHPALPV të grupit të kandidatëve për studentë që kanë aplikuar në maturën shtetërore por nuk kanë fituar programin e dëshiruar!
3. T'i kërkojë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit lejimin e regjistrimit të kandidatëve për studentë në SHPALPV, brenda të gjitha kritereve shtetërore dhe institucionale!
4. T'i kërkojë AKP, nëpërmjet legalizimit nga ana e MAS të statusit të këtyre kandidatëve si të regjistruar në SHPALPV, pajisjen me numra NIM të tyre në programet përkatëse në SHPALPV për vitin akademik 2016 – 2017!
5. T'i kërkojë Rektoratit të SHPALPV të ndjekë zbatimin e këtij Vendimi dhe përcjelljen e tij në MAS sipas të gjitha rregullave të komunikimit institucional!

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Rektor

Prof. Dr. Luan Gjoncaj

